

**eKesco.**

ONLINE BILL


fatura.kesco-energy.com

# MANUAL PËR PËRDORIMIN E APLIKACIONIT EKESCO




## 1. Shkarkimi i aplikacionit

Aplikacionin eKesco mund ta shkarkoni në PlayStore nëse përdorni telefon Android, dhe në AppStore nëse përdorni telefonin iPhone.



## 2. Regjistrimi

Për t'u regjistruar, duhet t'i plotësoni hapësirat e kërkuara me të dhënat tuaja.




Nëse më parë keni hapur llogari përmes webfaqes së KESCO, atëherë përdorni ato të dhëna për të përdorur aplikacionin.

Do të keni regjistrim valid, vetëm nëse plotësoni këto të dhëna:

- Mund të hapni vetëm një llogari me numrin tuaj personal.
- Emri dhe mbiemri duhet të përputhen me numrin personal.
- Mund të përdorni vetëm një e-mail për një llogari.
- Mund të përdorni vetëm një numër telefoni për një llogari.
- Fjalëkalimi duhet të ketë së paku 8 karaktere (përfshirë një numër dhe një shkronjë të madhe).

Nëse llogaria e re bëhet valide, atëherë do të pranoni një mesazh në telefon, menjëherë pas regjistrimit.

*Pas verifikimit me SMS, ju do të drejtoheni automatikisht në aplikacion.*



Nëse njehsori juaj është regjistruar më parë në një llogari, atëherë personi që hap llogarinë e dytë, do ta shohë këtë njoftim:

*Nëse personi vazhdon me regjistrim, atëherë personi që ka hapur llogarinë e parë, do të marrë njoftimin se edhe dikush tjetër është i regjistruar me njehsorin e njëjtë.*

Kjo lejon që disa persona të hapin llogari me njehsorin e njëjtë.



### 3. Menaxhimi i njehsorëve

Një përdorues mund të ketë një ose më shumë njehsorë të regjistruar në llogari. Për të menaxhuar njehsorët, klikoni në opsionin “Menaxho Njehsorët” në menynë kryesore, në anën e majtë të ekranit.


Për të larguar njehsorin, kliko “Fshij.”





Për të shtuar një njehsor të ri, kliko shenjën.

Për të shtuar njëshorin e ri, në hapësirën e zbrazët duhet të shkruani shifrën e konsumatorit. Nëse njëshori është i regjistruar në një llogari tjetër, atëherë aplikacioni do ta njoftojë llogarinë.

Në fund të aplikacionit gjeni informacionin për mbrojtjen e të dhënave.




Ju mund të emërtoni njëshorin sipas dëshirës tuaj. Për shembull: “Shtëpia”, “Dyqani”, etj.



Në rastet kur keni të regjistruar dy ose më shumë njëshorë, në opsionin “Konsumatori Aktiv” në faqen kryesore të aplikacionit, ju mund të bëni kalimin nga një njëshor në tjetrin.


## 4. Faturat

Faturën tuaj të fundit e gjeni në faqen kryesore në aplikacion.



Nëse klikoni në “Fatura e fundit”, atëherë do t’ju hapet faqja me detajet e faturës.

Nëse doni ta shihni faturën të printuar, klikoni në butonin lart.



## 5. Pagesa e faturës

Ju mund ta paguani faturën përmes aplikacionit në dy mënyra.

Me të klikuar opsionin “Pagesë Online”,  
ju shfaqen opsionet e pagesës.

*Me opsionin “Njehsorë të regjistruar”, juve ju shfaqen informacionet bazike të pagesës dhe shuma që po paguani. Me të klikuar në “Paguaj tani”, do të kaloni në faqen e pagesës.*

The screenshot shows the 'Pagesë Online' app interface. At the top, there's a blue header with a back arrow and the text 'Pagesë Online'. Below it, a white bar says 'Bëjë pagesë duke përdorur'. Two options are listed: 'NJEHSORËT E REGJISTR...' and 'BARKOD TË FATURËS', with the latter being selected. Below this, there are fields for 'Emri i konsumatorit' (A\*\*\*\* S\*\*\*\*\*), 'Adresa' (3\*\*\*\*\* B\*\*\*\*\* H\*\*\*\* N\*\*\*\* 1\*\*\*\*\*), 'Fatura e fundit' (with a blurred amount), and 'Balanci' (with a blurred amount and a Euro symbol). At the bottom, there's a 'Shuma €' field, a 'Vendos shumën' field, and a large blue button labeled 'PAGUJ TANI'.

This screenshot shows the 'Pagesë Online' app interface with the 'BARKOD TË FATURËS' option selected. The 'Barkodi i faturës' field is visible, with a barcode icon to its right. Below it, there's a 'Shuma €' field, a 'Vendos shumën' field, and a large blue button labeled 'PAGUJ TANI'. At the bottom, there are logos for 'Verified by VISA', 'MasterCard SecureCode', and 'TEB'.

*Me opsionin “Barkod të faturës”,  
ju mund të paguani faturën duke skanuar kodin në faturë.*

*Numri i referencës së pagesës*

*Butoni i skenimit të faturës*



Pasi të skanohet barkodi, do t'ju shfaqen informacione bazike të faturës, sikur që është shuma, dhe pastaj butoni për të vazhduar tutje do të shfaqet. Më pastaj mund ta procedoni pagesën duke plotësuar të dhënat e kartelës.

Me këtë opsion ju mund të paguani edhe për konsumatorët të cilët nuk i keni të regjistruar, por që posedoni faturat e tyre.

Nëse kryhet pagesa me sukses, ju do të pranoni konfirmimin përmes e-mailit.



## 6. Transaksionet

Në faqen “Transaksionet” mund të shihni të gjitha pagesat dhe faturat. Secila ndarje mundëson filtrimin në bazë të tipit, pagesat dhe faturat.



Me të klikuar te pagesa e bërë, hapet faqja me detajet e transaksionit.

## 7. Kalkulatori



Te kalkulatori, ju mund të kalkuloni shpenzimet duke u bazuar në leximin e fundit dhe në leximin aktual. Informatat se si të lexohet njehsori, mund t'i gjeni në opsionin “si ta lexoj njehsorin,” që është i paraqitur poshtë butonit dhe mësoni se si lexohet njehsori varësisht nga tipi që posedoni.



Në rastet kur konsumatorët kanë njehsorë që lexohen nga distanca, atëherë leximi bëhet në mënyrë automatike.

16:06 73%

### Kalkulimi

Shuma (€)  
[Shuma A1 + Shuma A2]

Tarifa fikse (€)

Neto (€)

TVSH (8% - €)

Shuma e faturës (€)

**Konsumatori**


Shifra e konsumatorit

Grupi tarifor  
4/02

**Kalkulimi**

	A1	A2
Gjendja paraprake (kWh)	22594.00	12609.00
Diferenca (kWh)	6.00	391.00
Konsumi (kWh)	6.00	391.00


Pasi të vendosni leximin e njehsorit dhe klikoni butonin “kalkulo”, ju shfaqet kjo faqe, ku paraqitet shuma dhe detajet tjera të kalkulimit.



## Informata tjera të rëndësishme

### Konsumi

Në faqen kryesore të aplikacionit ju mund të informoheni për vlerat e konsumit të energjisë elektrike.




Konsumi i energjisë i muajit të kaluar në krahasim me konsumin e energjisë mesatare të 12 muajve të fundit - kW


TABELË GRAFIK

	A1	A2
Janar 2019	172.00	36.00
Janar 2018	195.00	56.00
Janar 2018 deri Janar 2019 [Mesatarja]	141.83	47.50

Vlera e konsumit të energjisë përgjatë muajve të vitit aktual - kW



## Pikat e afërta të pagesës



Për të ditur se cilat janë pikat e shitjes më të afërta të KESCO, ju duhet të klikoni këtë buton.

Zyrat më të afërta të Kes-Co

- Elektrokosova**  
Bul."Bill Clinton" Nr.7  
Prishtinë
- Te Komuna**  
Rr."Kosova"  
Prishtinë
- Taslixhe**  
Rr."Nazim Gafurri"  
Prishtinë
- B. Bahtiri**  
Rr."Llapit" Nr.59  
Prishtinë
- Fushë Kosova**  
Rr."Nëna Terezë"kom. Apollonia B-19  
Fushë Kosovë
- Graçanicë**  
Graçanicë  
Prishtinë
- Kastriot**

Më pas ju shfaqet kjo faqe me adresat e pikave më të afërta. Për të parë lokacioni në hartë, atëherë klikojeni atë.

## Njoftimet

Njoftimet e rëndësishme për ju, si për shembull punimet e planifikuara dhe të tjera, mund t'i shihni në sinjalizuesin me ngjyrë të kuqë në këtë buton.



**eKesco.**  
ONLINE BILL  
[fatura.kesco-energy.com](http://fatura.kesco-energy.com)